

FJALA E DEPUTETIT SALI BERISHA

E ENJTE 14 KORRIK 2022

Të dashur qytetarë dhe qytetare,

Ky është një parlament, në të cilin vij vetëm për ju, sepse futem në një parlament njerëzish të shndërruar në skllavër nga kryetari i tyre; futem në këtë parlament njerëzish, të cilëve u hoqi të drejtën e votës në partinë e tyre dhe e shndërroi këtë parti, si në kohën e Enver Hoxhës, në Koza Nostra. Unë jam i vetëdijshëm se aty ku hiqet vota, hyn droga; aty ku nuk flet vota, flet mafia; aty ku nuk flet vota, flet krimi; aty ku nuk është vota, shkelmohet dinjiteti; aty ku përzihet vota, ka vetëm skllavëri dhe verbëri. Ndaj, shohim edhe këto sjellje të këtyre këtu. Por unë përsëri do të rri këtu për të mbrojtur interesat tuaja, sepse kanë ngritur një drejtësi unike në botë, të cilën nuk ua pranon kurrkush më dhe po kutërbon erë në mbarë Europën, e shndërruar në degë ekzekutivi; sepse ju, të dashur qytetarë, e humbët përfundimisht të drejtën, për të pasur një proces ligjor të drejtë, siç jua garantojnë Kushtetuta dhe Konventa Europiane.

Me dosjet e krijuara do të prisni 20 vjet, ose do të paguani qimet e kokës të Sadushi dhe sadushët për të afruar proceset gjyqësore. Ju për të pasur një proces gjyqësor do të paguani shumëfishin e asaj që paguanit më parë, për arsye se të vetuarit e partisë janë të betuarit e saj për të marrë çdo masë, çdo vendim në favor të qeverisë. Pyetini pak përfaqësuesit e SPAK-ut, të KLD-së, të KLGJ-së e me radhë t'ju thonë pse nuk i hetojnë sarajet e Edi Ramës me gjatësi themelesh 57 metra, me oborr 5 mijë metra, që ka deklaruar se e ka blerë me 2 euro, në një kohë kur shitej me 20 euro apo 40 euro në atë zonë! Pyetini pak pse nuk e hetojnë "pallatin pajë" të familjes Basha, për të cilin s'kanë asnjë faturë tatimore, doganore, bankare, ndërtimore, por e shpërblyen ndërtuesin vetëm para 3 javësh me 11 milionë euro, me 99% të fondit limit dhe i vetëm në garë!

Pyeteni pak këtë drejtësi pse nuk heton Edi Ramën, Arben Ahmetajn, Agaçin dhe Erion Veliain për aferën e tmerrshme të djegëseve 420 milionë euro të firmosur nga Kryeministri si kontratë,

duke deklaruar se shkeli ligjin, me një procedurë antiligjore që mund ta përdorin vetëm hajdutët e nivelit më të lartë. Pyeteni pak këtë drejtësi, që këta këtu i thurin lavde dhe apoteoza pse i blini çmimet e ushqimeve 7% më shtrenjtë se evropianët. Çfarë ka ndodhur këtu? A bëjnë ndonjë hetim këta? Pyetini pak pse e blini naftën njëlloj sa gjermanët. Këtu u dhanë shifra, por do t'i shtoj një të dhënë Dash Sulës. Në vitet 2012, 2013, të dashur qytetarë, Ballshi prodhonte 100 deri në 150 mijë tonë D2. Pra, po të shtojmë edhe importin, konsumi i naftës ishte rreth 700 mijë tonë dhe qarkullonte në vend. Po sot ku janë?!

Sot ministrja na raporton këtu naftën transit për në Kosovë dhe në Serbi si naftë që hyn në Shqipëri. Pyetini pak këta përfaqësues të drejtësisë se çfarë ndodhi me zyrtarin më të lartë të drejtësisë që u regjistrua nga policia, se kërkoi 500 mijë euro për të afruar gjyqin në Gjykatën e Lartë. E dhanë të gjitha mediet. A ishte ky Metani apo Sadushi, këtë nuk mund ta gjejnë. Pse? Sepse ata në medie ia hidhnin njëri-tjetrit, por është e sigurt se njëri prej tyre ishte. Pyetini pak se çfarë hetimi ka bërë kjo drejtësi për shfrytëzimin barbar të pasurive kombëtare. Janë kthyer në një mallkim të vërtetë për ju, qytetarë. A pasuroheni ju? A mëkëmbeni ju nga viti në vit nga shfrytëzimi i këtyre pasurive? Jo dhe jo, sepse oligarkët e qeverisë, njëlloj si kolonizatorë, ju shfrytëzojnë deri në palcë. Çfarë bëri Edi Rama për pasuritë natyrore? Hoqi rentën, o qytetarë.

Hoqi rentën, duke shkelur një marrëveshje ndërkombëtare të Shqipërisë. Ku shkoi renta? Në xhepat e qeverisë dhe të oligarkëve. Ajo ishte lënë për infrastrukturën lokale, për ju. Çfarë ndodh me këtë drejtësi? A e dini ju që për aferën e djegësve Erion Veliaj vazhdon, sikur s'ka ndodhur gjë, dhe disbursohen çdo ditë nga paratë tuaja 80 mijë euro për këta hajdutë? Çfarë bën kjo drejtësi? Cila drejtësi është kjo? A e dini ju se 7 kilometra rrugë nga Iba në Farkë kanë kushtuar 210 milionë euro? Ka kushtuar 30 milionë euro kilometri. Ka shkuar 40% më shtrenjtë se kilometri në tunelin e Kalimashit. 100% më shtrenjtë se kilometri në tunelin e Kërrabës. Hetojnë këta... Prandaj u thurin lavde këtu dhe i duartrokasin.

A e dini ju, qytetarë, që vëllezërit, motrat, nënat, baballarët tuaj vdisnin në Shqipëri nga COVID-i, si në asnjë vend tjetër në Europë, sepse ministria vidhte dhe vetëm vidhte fonde të caktuara nga buxheti që ishin për ndihmën tuaj? A e dini ju pse nuk hetojnë këta gjykatës dhe prokurorë, në një kohë kur qeveria merr nga ju 340 milionë euro nga çmimet e larta? I merr dhe i ndan me

oligarkët e saj dhe juve jua preu edhe atë fond minimal që jua dha para 3 muajsh. Pyeteni pak këtë zonjën e KLGJ-së: pse e mban ti sekret vetingun e Sokol Sadushit, Pupos dhe të gjykatësit tjetër të Gjykatës së Lartë? Çfarë sekreti është ai? Jua them unë. Sepse të tre ata e kanë vendin mbrapa hekurave. Të tre ata kanë pasuri kriminale të fshehura. Ata janë ushtarë të partisë, prandaj mbeten aty për të mbajtur peng.

A e dëgjuat ju ministrin e Brendshëm si recitonte? Sepse ai familjarisht ka marrë miliona nga ajo reformë. Ka marrë miliona! Pyeteni pak ç'është marrëveshja Llagami-Fico për dosjet tuaja, se si Delina Fico, bashkëjetuesja e ministrit, merr miliona për të shqyrtuar me anëtarët e Institutit East-West, dosjet tuaja sipas porosive të partisë...